



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të  
Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve Rinore

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për Projektet që kontribuojnë për zbatimin e aktiviteteve, fuqizimin dhe zhvillimin e pjesëmarrjes së të rinjëve të Komunës së Gjakovës bazuar sipas Planit të Veprimit për Rini 2023-2025.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

- Pjesëmarrja
- Edukimi jo-formal
- Punësimi dhe Ndërmarrësia
- Mjedisi i Sigurt dhe Edukimi Shëndetësor
- Vullnetarizmi dhe Punëtorët Rinor
- Integrimi Shoqëror, përfshirja e të rinjëve me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e komunitetit jo-shumicë

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **20.000 euro**. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është **500 euro**, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është **5,000 euro**.

5. Aplikantët dhe partnerët potencial për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

6. Afati për dorëzimin e propozimeve fillon nga data **11.03.2024** dhe përfundon me datën: **29.03.2024**

7. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

KOMUNA E GJAKOVËS

8. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit.
9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.
10. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
11. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.(të prezantohet certifikata e numrit fiskal, certifikata e regjistrimit dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar).
12. Së bashku me aplikacionin, OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshminë e Vërtetimit Tatimor të ATK-së, Letër konfirmimin ku vërtetohet që OJQ-ja është e regjistruar në Departamentit për OJQ-Ministria e Punëve të Brendshme dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së.
13. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ([kk.rks-gov.net/gjakove/](http://kk.rks-gov.net/gjakove/)).
14. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".
15. Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.
16. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
17. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së.